

VENDIM
Nr.424, datë 2.7.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHLLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993
“PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR,
DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin II “Shuma bazë e përfitimeve” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.7.2004 e në vazhdim, të jetë 7 266 (shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.”.

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit, të përcaktuar nga paragrafi i parë i këtij neni, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.7.2004 e në vazhdim, të jetë 2 980 (dy mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë në muaj.”.

2. Në kapitullin III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve” të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2004, e në vazhdim, të jetë 4 767 (katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë.

Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	Lekë
Dega e sigurimit të sëmundjeve	91
Dega e sigurimit të barrë lindjeve	262
Dega e sigurimit të pensioneve	3 401
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	57
Dega e sigurimit të papunësisë	569
Sigurimet shëndetësore	387

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Punëdhënësi derdh kontribute të detyrueshme në masën 41.9 për qind të pagës mujore, sipas listëpagesave. Nga data 1.7.2004 e në vazhdim paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të jetë 11 376 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, ndërsa paga maksimale të jetë 56 881 (pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë.”.

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Punëdhënësi privat, i vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në ortakëri, që ushtrojnë veprimtari ekonomike (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2004 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 11 376 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.”.

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Pjesëtarët e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësin privat dhe të vetëpunësuarin (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2004 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 11 376 (njëmbëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh.”.

- Në pikën 5 shifra “10 343” zëvendësohet me “11 376”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2004.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano